

VENDIM
Nr. 861, datë 21.10.2015

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. GJOVALIN BUSHI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Gjovalin Bushi në masën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të mjekimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama